



VROJTIM

MBI

**GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E FAMILJEVE NË
SHQIPËRI**

Shënim metodologjik dhe pyetësor

**BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

PËRMBAJTJA

1. Karakteristika të përgjithshme	3
2. Motivimi dhe qëllimi i vrojtimit.....	3
3. Karakteristikat e përgjithshme të pyetësorit.....	4
4. Përpunimi i rezultateve të pyetësorit	5
Aneks I.....	6

1. Karakteristika të përgjithshme

Vrojtimet në terren të grupeve të caktuara, për qëllime të ndryshme studimore, janë bërë tashmë një mjet i përdorur gjerësisht nga bankat qendrore, përmes të cilave realizohet marrja, në kohë reale, e atij lloj informacioni që është i vështirë për t'u përfshirë në të dhënat zyrtare. Banka e Shqipërisë prej vitesh zhvillon me sukses disa vrojtime, të cilat sigurojnë një informacion të gjerë, kryesisht cilësor dhe më rrallë sasior, mbi agjentë të ndryshëm ekonomikë, në lidhje me zhvillime të kaluara, aktuale apo të pritshme. Rezultatet e këtyre vrojtimeve përdoren vazhdimisht nga Banka e Shqipërisë në analiza e raporte periodike, krahas statistikave zyrtare.

Që prej vitit 2010, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), Departamenti i Stabilitetit Financiar (DSF), pranë Bankës së Shqipërisë, zhvillon **çdo 6 muaj** (në maj dhe në nëntor), një vrotim mbi *'Gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve në Shqipëri*.

Ky vrotim përdor një **kampion prej 1200 familjesh** të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme dhe të shpërndara në të gjithë territorin e vendit, me shkallë përfaqësimi në nivel urban dhe rural. Banka e Shqipërisë ka bashkëpunuar me INSTAT-in për përcaktimin e karakteristikave të kampionit të vrotuar dhe shtrirjen gjeografike të tij, si edhe për anketimin në terren të kampionit të përzgjedhur. Përcaktimi i kampionit përfaqësues realizohet nga INSTAT-i sipas metodologjive statistikore përkatëse. Kampioni është pothuaj i fiksuar dhe rishikohet për të përjashtuar ato familje që nuk përgjigjen apo, për arsye të ndryshme (largim, ndarje nga jeta etj.), nuk banojnë më në adresën e përfshirë në kampion. Familjet e përjashtuara nga kampioni zëvendësohen me familje të reja, me karakteristika të ngjashme. Procesi i rishikimit është i kufizuar dhe nuk e tejkalon 10% të kampionit gjatë një viti.

Mbledhja e informacionit bëhet përmes pyetësorit të parapërgatitur nga DSF-ja dhe dërguar INSTAT-it. Intervista zhvillohet mbi bazë vullnetare, ballë-për-ballë, zakonisht me kryefamiljarin apo një anëtar tjetër në moshë madhore të secilës familje, i cili ka dijeni për situatën financiare të saj. Kjo mënyrë është zgjedhur në bazë të supozimit që të intervistuarit kanë njohuritë e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave të pyetësorit për periudhat e kaluara, aktuale dhe për ato të ardhshme.

Plotësimi i pyetësorëve bëhet në formë anonime. Informacioni i mbledhur mbetet konfidencial dhe përdoret vetëm për qëllime studimore të Bankës së Shqipërisë.

2. Motivimi dhe qëllimi i vrotimit

Monitorimi i ecurisë së sistemit financiar në vend nga Banka e Shqipërisë, bëhet duke u nisur nga të dhënat e marra në formën e raportimeve nga institucionet financiare bankare dhe jobankare. Pjesa e të dhënave mbi huadhënien për ekonominë, pavarësisht nivelit të detajuar të tyre, lejon një analizim të situatës me fokus në sektorin bankar, pra gjithnjë në drejtimin bankë-sektor privat. Për këtë arsye,

është e vështirë të krijohet një ide e plotë mbi këtë marrëdhënie dhe ndikimin e saj në ekonominë e vendit.

Ndërmarrja e këtij vërtimi mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve, është **motivuar** nga nevoja për të pasur një këndvështrim sa më të gjerë dhe të plotë mbi situatën financiare të familjeve shqiptare, veçanërisht në marrëdhënie me fenomenin e huamarrjes formale (nga institucionet financiare në vend) dhe asaj joformale. **Qëllimi kryesor** i tij është të sigurojë të dhëna plotësuese mbi aspekte të ndryshme të financave të familjeve shqiptare, të cilat nuk mund të sigurohen nga të dhënat zyrtare.

Informacioni i mbledhur nga ky vërtim, përpunohet për të nxjerrë në mënyrë indirekte rezultate mbi rreziqet që mund t'i vijnë sistemit financiar nga sektori i familjeve. Në përgjithësi, informacioni i mbledhur nga ky vërtim shërben për të plotësuar dhe thelluar më tej analizat që realizohen aktualisht nga Departamenti i Stabilitetit Financiar, duke krijuar një kuadër më të qartë të situatës në vend.

3. Karakteristikat e përgjithshme të pyetësorit

Pyetësori mbi 'Gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve' përmban 26 pyetje të organizuara në 5 rubrika.

I- Karakteristikat demografike dhe të punësimit të familjes

Kjo rubrikë përmban 3 pyetje lidhur me: vendndodhjen e familjes, përbërjen dhe mënyrën e sigurimit të të ardhurave. I intervistuari duhet t'i përgjigjet pyetjeve duke iu referuar përbërjes së plotë të familjes së tij.

II- Karakteristikat e të ardhurave/shpenzimeve të familjes

Kjo rubrikë përmban 7 pyetje, ku kërkohet informacion mbi: burimet e tjera të të ardhurave, nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve totale mujore të familjes, të ardhurat në monedhë të huaj dhe nëse kanë (një ose më shumë) hua të papaguar në momentin e intervistimit.

III- Karakteristikat e huasë së familjes

Kjo rubrikë përbën pjesën kryesore të pyetësorit dhe përmban 11 pyetje sasiore që synojnë të marrin informacion mbi huatë ekzistuese (pra huaja/huatë e marrë/a dhe ende e/të pashlyer/a), nga të gjithë anëtarët e familjes, në momentin e intervistimit. Në rast se në momentin e intervistimit, një familje ka më shumë se një hua të pashlyer, pavarësisht madhësisë, llojit dhe formës së tyre, informacioni duhet të merret për totalin e huave, sipas mënyrës së kërkuar në secilën pyetje. Pyetjet e kësaj rubrike synojnë të marrin informacion mbi burimin, qëllimin, monedhën, formën e huamarrjes, karakteristikat e pagesës së saj, formën e garantimit etj.

IV- Ngarkesa e huasë më të madhe të familjes

Kjo rubrikë përmban 7 pyetje cilësore lidhur me: ndryshimin e këstit të huasë, aftësinë paguese të tashme të familjes dhe parashikimin për 6 muajt e ardhshëm, mundësinë e marrjes së një huaje të re në të ardhme etj. Në rast se familja e intervistuar, në momentin e intervistimit, ka më shumë se një hua të pashlyer, pavarësisht burimit të marrjes së huave dhe karakteristikave të tyre, pyetjet e kësaj rubrike duhet të plotësohen nga i intervistuari duke iu referuar vetëm njëres prej huave, huasë më të madhe dhe që rëndon më shumë buxhetin e familjes.

V- Pasuria e familjeve

Kjo rubrikë përmban vetëm 2 pyetje dhe ka si qëllim të mbledhë informacion mbi pasurinë e familjeve të përfshira në vrojtim. Si pasuri konsiderohen: pronat e patundshme (banesat, tokat, godinat etj.); investimet e familjes në asete të ndryshme financiare (si depozita, llogari, investime në bono thesari, aksione etj.); dhe paratë *cash*.

Pyetjet në pyetësor mbulojnë tre periudha të ndryshme kohore (gjashtëmujori i kaluar, periudha aktuale e plotësimit të pyetësorit dhe gjashtëmujori pasardhës), duke mundësuar krijimin e një vazhdimësie të dhënash, si edhe kryerjen e parashikimeve lidhur me huamarrjen e këtij agjenti ekonomik.

Pyetësori i plotë paraqitet në **Aneksin I**.

4. Përpunimi i rezultateve të pyetësorit

Hedhja e të dhënave të vrojtimin mbi "Gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve" kryhet nga Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën e Shqipërisë, sipas një formati të hartuar paraprakisht nga specialistët e Departamentit të Stabilitetit Financiar. Përpunimi i të dhënave dhe analiza e rezultateve realizohen nga Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Përdorimi i rezultateve të vrojtimin në mënyrë të vazhdueshme siguron ndërtimin e serive kohore, të cilat jo vetëm plotësojnë bashkësinë e të dhënave zyrtare ekzistuese, por edhe bëjnë të mundur ndërtimin e treguesve të ndryshëm. Këto të dhëna janë të nevojshme në përgatitjen e analizave ekonomike dhe në parashikimin e prirjeve në të ardhmen, duke ndihmuar procesin e vendimmarrjes në Bankën e Shqipërisë.

Një përmbledhje e rezultateve të këtij vrojtimi paraqitet në Raportin 6-mujor të Stabilitetit Financiar.

Ky vrojtim mund të jetë subjekt ndryshimesh sipas nevojës, me qëllim përshtatjen me praktikën më të mira, rritjen e cilësisë së informacionit të mbledhur dhe përmirësimin e mëtejshëm të analizës së zhvillimeve të aktivitetit huadhënës, në këndvështrimin e ndërmarrjeve.

Aneks I.

PYETËSOR MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE TË HUASË SË FAMILJEVE

Data e intervistës: _____
Nr. i pyetësorit: _____

Mosha e të intervistuarit: _____
Gjinia: _____

RUBRIKA I: KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE DHE TË PUNESIMIT TË FAMILJEVE

P.1 Qyteti/Fshati _____ **P.2 Sa është numri i anëtarëve në familjen tuaj?** _____

P.3 Nga i siguronit të ardhurat në familjen tuaj? (përcakto në vendet bosh nr. e anëtarëve të familjes që sjellin të ardhura, sipas çdo alternative)

- | | |
|--|--|
| 1. punësuar në sekt. shtetëror _____ (nr. i personave) | 5. i vetëpunësuar në sek. bujqësor _____ |
| 2. punësuar në sekt. privat jobujqësor _____ | 6. në pension _____ |
| 3. punësuar në sek. privat bujqësor _____ | 7. në asistencë sociale për papunësi _____ |
| 4. i vetëpunësuar në sek. jobujqësor _____ | 8. në emigracion _____ |
| | 9. tjetër (përcakto burimin) _____ |

RUBRIKA II: KARAKTERISTIKAT E TË ARDHURAVE/SHPENZIMEVE TË FAMILJEVE

P.4 Përveç të ardhurave nga burimet e përmendura në pyetjen 3, a ka ndonjë burim tjetër të qëndrueshëm të ardhurash familja juaj? (një alternativë)

1. Po 2. Jo

P.5 Nëse 'Po', cili është ky burim? (një ose më shumë alternativa)

- | | |
|---|--|
| 1. qira | 3. interesa nga para të dhëna hua të tretëve |
| 2. interesa nga kursimet (depozita, bono thesari) | 4. tjetër (përcakto) _____ |

P.6 Sa është afërsisht vlera TOTALE e të ardhurave mujore të familjes suaj, së bashku në LEKË dhe në VALUTË? (një alternativë; në lekë të reja)

1. deri në 17 mijë lekë
2. 17 mijë – 50 mijë lekë
3. 50 mijë – 100 mijë lekë
4. 100 mijë– 200 mijë lekë
5. mbi 200 mijë lekë

P.7 Ç'pjesë e të ardhurave të përgjithshme mujore të familjes suaj, është në MONEDHË TË HUAJ? (një alternativë)

- | | |
|---|------------------------|
| 1. nuk kam fare të ardhura në monedhë të huaj | 3. mbi 10% deri në 50% |
| 2. deri në 10% | 4. mbi 50% |

P.8 Nëse keni të ardhura në MONEDHË TË HUAJ, në cilën monedhë janë ato? (një alternativë)

1. kryesisht në euro
2. kryesisht në usd
3. monedhë tjetër (përcakto monedhën) _____

P.9 Sa është afërsisht vlera TOTALE e shpenzimeve mujore të domosdoshme për jetesën e familjes tuaj (ushqim/veshmbathje/strehim/energji/ujë/ilaçe/edukim - duke përfshirë shpenzimet mujore për shlyerjen e huasë/huave), së bashku në LEKË dhe në VALUTË? (një alternativë; në lekë të reja)

1. deri në 10 mijë lekë
2. 10 mijë - 20 mijë lekë
3. 20 mijë - 50 mijë lekë
4. 50 mijë - 100 mijë lekë
5. mbi 100 mijë lekë

P.10 A ka familja juaj (ju ose cilido anëtar tjetër i familjes me të cilën jetoni), një ose më shumë hua për të paguar aktualisht? Nëse 'Po', sa është numri i këtyre huave?

1. Po _____(nr. i huave)
2. Jo

Nëse përgjigjja është "Po", vijo më poshtë! Nëse përgjigjja është "Jo", kalo tek pyetja 24!

Rubrika III: KARAKTERISTIKAT E HUASË/HUAVE TË FAMILJEVE

(Në këtë rubrikë, i intervistuari duhet të përgjigjet për të gjitha huatë e marra dhe ende të papaguara të familjes së tij, në momentin e intervistimit).

P.11 Në cilën monedhë e keni marrë huanë (huatë)? *(një ose disa alternativa; plotësoni numrin e huave për secilën zgjedhje)*

1. në lekë _____ (nr. i huave)
2. në euro _____ (nr. i huave)
3. në dollar amerikanë _____ (nr. i huave)
4. në monedhë tjetër (përcakto) _____ (nr. i huave)

P.12 Në cilën formë është huaja (huatë) që keni marrë? *(një ose disa alternativa; plotësoni numrin e huave për secilën zgjedhje)*

1. kredi nga banka _____ (nr. i huave)
2. kredi "overdraft"/shlyhet me një shumë të vetme _____ (nr. i huave)
3. kartë krediti _____ (nr. i huave)
4. cash/para në dorë _____ (nr. i huave)
5. mall ende i papaguar _____ (nr. i huave)
6. formë tjetër (përcakto) _____ (nr. i huave)

P.13 Për çfarë qëllimi e keni marrë huanë (huatë)? *(një ose disa alternativa; plotësoni numrin e huave për secilën zgjedhje)*

- | | |
|--|--|
| 1. blerje/riparim shtëpie/toke _____ (nr. i huave) | 4. studime _____(nr. i huave) |
| 2. zhvillim biznesi _____ (nr. i huave) | 5. pushime _____ (nr. i huave) |
| 3. blerje makine _____ (nr. i huave) | 6. konsum _____ (nr. i huave) |
| | 7. tjetër (përcakto qëllimin) _____(nr. i huave) |

P.14 Si është garantuar huaja(huatë) që keni marrë? *(një ose disa alternativa; plotësoni numrin e huave për secilën zgjedhje)*

1. nuk ka garanci _____ (nr. i huave)
2. një pronë të familjes _____ (nr. i huave)
3. një depozitë në të holla të familjes _____ (nr. i huave)
4. një pronë të një personi jashtë familjes _____ (nr. i huave)
5. një garanci të lëshuar nga një person jashtë familjes _____ (nr. i huave)
6. tjetër(përcakto garancinë) _____ (nr. i huave)

P.15 Ç'pjesë të të ardhurave tuaja mujore zë totali i pagesës së huasë (huave)? *(një alternativë)*

- | | |
|----------------|------------|
| 1. deri në 10% | 4. 51-70% |
| 2. 10-30% | 5. mbi 70% |
| 3. 31-50% | |

P.16 Nga e keni marrë huanë(huatë)? (Rrethoni burimin e huasë dhe plotësoni nr. e huave, normën e interesit dhe shumën totale që ka mbetur ende për t'u paguar, sipas monedhës/monedhave përkatëse.

	Burimi i huasë	Nr. i huave	% e Interesit	Vlera totale e huasë që ka mbetur për t'u paguar	Kësti mujor i huasë	Monedha	Sa kohë ju ka mbetur për të shlyer kredinë (në vite)
1.	Bankë (p.sh. kredi me afat/overdarft/kartë kreditit etj.)					Lekë (të reja)	
						Euro	
						Dollarë	
						Tjetër (specifiko) _____	
2.	Institucion financiar jobankar					Lekë	
						Euro	
						Dollarë	
						Tjetër (specifiko) _____	
3.	Person/a fizikë (p.sh. familjarë/të afërm/miq/të njohur etj.)					Lekë	
						Euro	
						Dollarë	
						Tjetër (specifiko) _____	
4.	Hua në formë malli (psh. nga dyqane/firma/të tretë etj.)					Lekë	
						Euro	
						Dollarë	
						Tjetër (specifiko) _____	
5.	Burim tjetër huamarrje (Specifiko burimin) _____					Lekë	
						Euro	
						Dollarë	
						Tjetër (specifiko) _____	

P.17 Si e paguani huanë (huatë)? (një ose më shumë alternativa, në varësi të numrit të huave. Në vend të "?" vendos një nga numrat 1,3,6,12)

1. shumë të njëjtë, çdo ____? muaj _____ nr. i huave
2. shumë të ndryshueshme, çdo ____? muaj _____ nr. i huave
3. një shumë e vetme në fund të periudhës _____ nr. i huave
4. shuma të ndryshme, në periudha të ndryshme _____ nr. i huave
5. tjetër(përcakto) _____ nr. i huave

RUBRIKA IV: NGARKESA E HUASË MË TË MADHE TË FAMILJES

(Në këtë rubrikë, i intervistuari duhet të përgjigjet vetëm për huanë më të madhe dhe ende të papaguar të familjes së tij, në momentin e intervistimit).

P.18 Si ka ndryshuar kësti mujor i huasë së familjes suaj (huasë më të madhe, në rast se janë më shumë se një), në 6 muajt e fundit? (një alternativë)

1. nuk ka ndryshuar
2. është rritur pak
3. është rritur ndjeshëm
4. është ulur pak
5. është ulur ndjeshëm

P.19 Si ka qenë aftësia juaj paguese për shlyerjen e detyrimit të huasë (huasë më të madhe, në rast se janë më shumë se një) në 6 muajt e fundit? (një alternativë)

1. nuk ka ndryshuar 2. përmirësuar 3. është përkeqësuar

P.20 Cilat janë arsyet për përgjigjen e pyetjes 19? (një ose disa nga nënalternativat)

1. **Nuk ka ndryshuar** sepse:
 - a.1 kushtet e të ardhurave dhe të shpenzimeve nuk kanë ndryshuar;
 - a.2 arsye tjetër (përcakto) _____.
2. **Është përmirësuar** sepse:
 - b.1 janë rritur të ardhurat familjare;
 - b.2 kanë rënë shpenzimet e domosdoshme;
 - b.3 ka rënë vlera e këstit të huasë;
 - b.4 arsye tjetër (përcakto) _____.
3. **Është përkeqësuar** sepse:
 - c.1 kanë rënë të ardhurat familjare;
 - c.2 janë rritur shpenzimet e domosdoshme;
 - c.3 është rritur vlera e këstit të huasë;
 - c.4 arsye tjetër (përcakto) _____.

P.21 Në raste se aftësia juaj paguese "është përkeqësuar", në ç'mënyrë mendoni të përballoni vështirësitë në pagesën e huasë? (një alternativë)

1. shitje/dhënie me qira e një prone të familjes
2. ulje e shpenzimeve të familjes
3. kërkimi i një pune të përkohshme
4. kërkesë ndaj huadhënësit për të lehtësuar kushtet e huasë
5. marrje e një huaje të re, me kushte më të favorshme
6. mënyrë tjetër (specifiko) _____

P.22 Si mendoni se do të jetë aftësia juaj për të paguar huanë (ose huanë më të madhe të familjes në rast se ka më shumë se një) në 6 muajt e ardhshëm, duke u nisur nga momenti aktual? (një alternativë)

1. do të mbetet e njëjtë 2. do të rritet 3. do të ulet

P.23 Cilat janë arsyet për përgjigjen e pyetjes 22? (një ose disa nga nën alternativat)

1. **Do të mbetet e njëjtë** sepse:
 - a.1 kushtet e të ardhurave/shpenzimeve nuk do të ndryshojnë;
 - a.2 arsye tjetër (përcakto) _____.
2. **Do të rritet** sepse:
 - b.1 të ardhurat familjare do të rriten;
 - b.2 shpenzimet e domosdoshme do të ulen;
 - b.3 vlera e këstit të huasë do të bjerë;
 - b.4 tjetër (përcakto) _____.
3. **Do të ulet** sepse:
 - c.1 të ardhurat familjare do të ulen;
 - c.2 shpenzimet e domosdoshme do të rriten;
 - c.3 vlera e këstit të huasë do të rritet;
 - c.4 tjetër (përcakto) _____.

P.24 Sa është mundësia që familja tuaj të kërkojë një/ose më shumë hua në 6 muajt e ardhshëm? (një alternativë)

(Kjo pyetje i drejtohet të gjithë familjeve të intervistuar, pavarësisht nëse kanë apo jo hua aktualisht.)

- | | |
|--------------------------|---------------------|
| 1. nuk ekziston mundësia | 3. ka shumë mundësi |
| 2. ka pak mundësi | 4. është e sigurve |

RUBRIKA V: PASURIA E FAMILJEVE

P.25 Çfarë lloj prone (pronash) të patundshme zotëron familja juaj dhe sa mendoni se vlen prona juaj (pronat tuaja) në këtë moment? A përdoret aktualisht kjo pronë si kolateral për kredinë (kreditë ekzistuese)? (një ose më shumë alternativa)

	Lloji i pronës	Prona 1 Vlera e pronës		Përdoret si kolateral?		Prona 2 Vlera e pronës		Përdoret si kolateral?		Prona 3 Vlera e pronës		Përdoret si kolateral?	
		Lekë (të reja)	Euro	PO	JO	Lekë (të reja)	Euro	PO	JO	Lekë (të reja)	Euro	PO	JO
a	Shtëpi banimi	Lekë (të reja)				Lekë (të reja)				Lekë (të reja)			
		Euro	PO	JO	Euro	PO	JO	Euro	PO	JO			
b	Tokë	Lekë (të reja)				Lekë (të reja)				Lekë (të reja)			
		Euro	PO	JO	Euro	PO	JO	Euro	PO	JO			
c	Dyqan	Lekë (të reja)				Lekë (të reja)				Lekë (të reja)			
		Euro	PO	JO	Euro	PO	JO	Euro	PO	JO			
d	Godinë	Lekë (të reja)				Lekë (të reja)				Lekë (të reja)			
		Euro	PO	JO	Euro	PO	JO	Euro	PO	JO			
e	Tjetër	Lekë (të reja)				Lekë (të reja)				Lekë (të reja)			
	(specifiko)	Euro	PO	JO	Euro	PO	JO	Euro	PO	JO			
f	Nuk kam asnjë pronë												

P.26. Çfarë lloj asetesh financiare zotëron familja juaj brenda ose jashtë vendit? (një ose më shumë alternativa)

1. depozitë dhe/ose llogari në bankë
2. bono thesari të qeverisë
3. sigurim jete
4. fond privat pensioni
5. aksione të një kompanie
6. kursime në para (të mbajtura jo në bankë ose institucion tjetër financiar)
7. kursime në para të dhëna hua dikujt
8. lloj tjetër aset financiar (përcakto) _____
9. nuk kam asnjë lloj aset financiar

